



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:034638
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05709724

K.DH.SH.II.nr.311/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, ne çështjen juridike përbarimore të kreditorit Kompania e Ujësjetës Rajonal “Gjakova” Sh.A., me numër biznesi 70433553 me seli në Gjakovë, rr. “UÇK” nr.7, kundër debitorit Komuna e Gjakovës, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1795/22 të datës 21.12.2023, me datën 20.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetësi “Gjakova” SH.A., me seli në Gjakovë, rr. “UÇK” nr.7, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1795/22 të datës 21.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar. KPPP.nr. 1795/22 të datës 21.12.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Gjakovës, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 673/21, i lejuar më datë 29.12.2021, nga Përbaruesi Privat Gëzim Gjoshi **ANULOHET**.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar të gjendjës faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm: Ektstrati nga librat e kontabilitetit me numër 2189 I datës 28.12.2021, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 673/21, të datës 29.12.2021, me të cilin është urdhëruar debitori, që në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 181,466.89, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Ndërsa, debitori prapësimin e ka paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se debitori nuk ka pranuar asnjë faturë nga kreditori për borxhin e pretenduar, ashtu që ekstrakti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim është i njëanshëm dhe nuk i plotëson kushtet për të shërbyer si document i besueshëm në kuptim të dispozitave të LPP-së, ndërsa ka shtuar se borxhi fare nuk ka të bëjë me debitorin ngase nuk ekziston asnjë marrëveshje mes palëve për furnizim me ujë të Stadiumit të Qytetit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit në prapësim nuk qëndrojnë për faktin se, propozimi për përmbartim është paraqitur mbi bazën e ekstraktit i cili përbën document përmbartimor në kuptim të nenit 21 dhe 29 të LPP-së, po ashtu kreditori i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit se me kreditorin nuk kanë marrëveshje për furnizim me ujë

në Stadiumin e Qytetit, duke theksuar se kanë kontratë për shërbime të datës 27.04.2018 ndërsa debitori emërtohet me kodin 2189. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe urdhri të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, me arsyetim se sipas nenit 29 paragrafi 1 I LPP-së përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.2 e të njëjtit nen përcakton ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave si dokumente të besueshëm sipas së cilave mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla, kurse me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër sipas nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së ekstrakti në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se përmbart të meta në raport me objektin e detyrimit, përkatësisht i njëjti ekstrakt nuk pasqyron borxhin e debitorit si rezultat I furnizimit me ujë, mirëpo në ekstrakt është ngarkuar borxhi në emër të rikthimit të humbjeve për shkak të kyçeve ilegale në rrjetin e ujësjellësit. Po ashtu gjykata duke u bazuar nga të lartecëkura përkatësisht proceverbalin nr.2189 ku është konstatuar se përgjatë kontrollit janë hasur dy kyçje ilegale, si dhe shkresën e kreditorit drejtuar debitorit të datës 21.10.2019, përmesë së cilës është njoftuar debitori se ujin e shpenzuar nga kyçje ilegale do ta faturojnë tek debitori në bazë të rregullave të brendshme, si dhe kreditori në seancën dëgjimore ka deklaruar se faturimi i borxhit të pasqyruar në ekstrakt është bërë edhe mbi bazën e rikthimit të humbjeve për shkak të kyçeve ilegale. Krejt në fund ka cek se sipas nenit 29 pika 1.2 të LPP-së është përcaktuar shprehimisht se dokumenti i besueshëm janë ekstraktet të cilat për objekt detyrimi kanë borxhin e krijuar si rezultat i furnizimit me ujë, ndërsa kreditori në ekstrakt ka faturoar borxhin për humbjen e ujit në rrjet të ujësjellësit për shkak të kyçeve ilegale dhe jo borxhin si rezultat i

furnizimit me ujë, ekstrakti mbi bazën e së cilit është inicuar procedura përbarimore është me të meta dhe si e tillë nuk përbën document të besushëm dhe nuk është I përshtatshëm për përbarim.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka aprovuar propësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës shihet qartë se ekstrakti e larte cekur në nuk i plotëson kushtet për të qenë dokumenti i përshtatshëm për përbarim në kuptim të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së. Kjo për faktin se nga vet deklaratimet e kreditorit, rezulton se i njëjti ka faturuar borxh në emër të humbjeve të ujit në rrjetin publik të ujësjellësit dhe jo në emër të konsumit apo furnizimit me ujë.

Andaj gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar. Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të kreditorit, por të njëjta mbesin të pabazuara pasi që të njëjtat pretendime janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe për të cilat ka dhënë sqarime të mjaftushme për të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj pretendimet ankimore nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.311/24, me datë 20.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2024:034638
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05709724